

## *Sesioni 1, Grupi i Punës II (Drejtësi, Liri, Siguri)*

### *Tema: Politikat e migracionit dhe azilit*

**18.06.2015**

#### *Zhvillimet aktuale*

Grupi i punës vlerësoi si zhvillime pozitive të deritanishme në kuadër të Kapitullit 24, miratimin e Ligjit të Policisë së Shtetit, Strategjinë Ndërsektoriale të Menaxhimit të Integruar të Kufijve, Strategjinë e Luftës ndaj Trafikimit të Personave, Aplikimin online Raporto – Shpëto, etj.

U konsiderua i suksesshëm Aplikacioni Raporto-Shpëto , i cili po kontribuon rritjen e ndërgjegjësimit mbi trafikimin e qenieve njerëzore, rritjen e aftësive së publikut për të raportuar trafikimin, dhe të ndihmojë që viktimat të lidhen me shërbimet dhe mbështetjen e duhur.

Në kuadër të Ligjit të ri të Azilit (miratuar në tetor 2014), në përputhje të plotë me rekomandimet e BE-së, vlerësohet si pozitive pajisja me dokumenta udhëtimi e refugjatëve, procesi i dhënies së statusit të refugjatit e njëkohësisht ofrimi i një niveli të lartë sigurie.

Zyrat e konsultimit e sportelet e ngritura nën varësi të Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, ofrojnë informacione të shumta për emigrantët e kthyer mbi arsimin, punësimin, formimin profesional, hapje e ngritje biznesi. Shihen si pozitive bashkëpunimet ndërinsitucionale si psh: financimet e ofruara nga Ministria e Bujqësisë për fermerët e kthyer dhe bashkëpunime nga Ministria e Arsimit sa i takon nxënësve të familjeve të rikthyera që kanë nevojë për edukimin parauniversitar.

#### *Problematika & Rekomandime:*

- Gjatë periudhës 2011-2015 rezulton një rritje e aplikimeve për azilkërkues në Shqipëri (kryesisht tranzitorë). Si rezultat i fluksit të madh të azilkërkuesve, nevojitet një mirëmenaxhim i situatës në sajë të sigurimit të burimeve të mjaftueshme njerëzore në **Policinë e Kufirit**. (Stafi 1 polic për 50 azilkërkues është i papërbalueshëm).

- Grupi i punës sheh si nevojë **ngritjen e qendrave efektive pritëse** të veçanta fillimisht në jug dhe më pas në veri të vendit.
- Grupi i Punës rekomandoi krijimin e një platforme ndërinsitucionale të **Analizës së riskut të imigracionit të parregullt**, të forcohet bashkëpunimi dhe koordinimi i institucioneve dhe mekanizmave të mbikqyrjes.
- Në përgatitjen dhe prezantimin e **Profilit të ri të Migracionit** (i cili do të finalizohet në një hark kohor prej 20 ditësh), të ketë bashkëpunim mes përfaqësuesve të Ministrisë të Punëve të Brendshme dhe shoqërisë civile në sigurimin dhe plotësimin me të dhëna statistikore si dhe track recordeve të vlerësimit të menaxhimit të migracionit.
- Si rezultat i mungesës së një qasjeje gjithëpërfshirëse për politikën e migracionit dhe ekzistencës së një sërë dokumentesh të shpërndara në këtë kuadër, sugjerohet një **dokument përmbledhës e gjithëpërfshirës**, si dhe pasja e instrumenteve më konkrete dhe praktike për emigrimin.
- Në muajin tetor 2015 pritet të rikthehen 90 % e azil-kërkuesve pas plotësimit të afatit të vlerësimit për azil. Azil-kërkuesit në Gjermani, janë kryesisht nga qarqet e Kukësit dhe Korçës, këta të fundit emigrantë të ardhur nga Greqia për shkak të krizës greke, të cilët nuk kanë arritur të ri-integrohen në shoqërinë shqiptare dhe kanë konsideruar zgjidhje azilin në Gjermani. Është e nevojshme të kryhet një **analizë e arsyeve të largimit të qytetarëve shqiptarë** në kërkim të azilit në vende të ndryshme në BE, e veçanërisht në Gjermani.
- Fenomeni i të miturve të pashoqëruar (rreth 1200 në Itali), vazhdon të jetë një problem shqetësues. Rezulton se nuk ka qendra pritjeje për të miturit. Pavarësisht se ka bashkëpunime mes Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Ministrisë së Punës, Mirëqenies Sociale dhe Rinisë në lidhje me këto problematike, sugjerohet **rishikimi i sistemit të mbrojtjes së të miturve të pashoqëruar** në Shqipëri, legjislacioni ka nevojë për përmirësime.
- Në kuadër të Strategjisë së ri-integrimit të shtetasve të rikthyer, shihet si e domosdoshme që **sportelet ndihmëse** të ofrojnë një paketë me informacion më të përmbledhur dhe me këshilla praktike e konkrete për emigrantët e rikthyer, duke përfshirë këtu grupet vulnerabël dhe nevojat e tyre specifike.
- Si rezultat i zbatimit të Reformës Administrative Territoriale, nevojitet **riorganizimi i Shërbimit Social Shtetëror**, konkretisht në ristrukturimin e Drejtorive Rajonale në rrethe të Shqipërisë.
- Janë të paregjistruar (deklaruar vullnetarisht pa shtetësi) rreth 7000 persona në Shqipëri. Rekomandohet të ndërmerren hapa të njëpasnjëshëm si:

**identifikimi i nevojave, ofrimi i informacionit, e më pas regjistrimi.** Ndër këta, përbëjnë problem romët, fëmijët e familjeve të rikthyera nga emigrimi, të cilët rezultojnë të parregjistruar dhe drejtpërdrejt kjo çon në probleme sa u takon sidomos edukimit të tyre dhe marrjes së shërbimeve të tjera publike.

*Pjesëmarrës në Grupin e Punës:*

### **Institucione shtetërore**

**Ministria e Punëve të Brendshme:** Zv Min. Elona Gjebrea

Drejtoria e Përgjithshme e Politikave të Zhvillimit, Planifikimit Strategjik dhe Integrimit - Genta Bektashi

Drejtoria për Shtetësinë dhe Refugjatët - Alma Mele

### **Policia e Shtetit**

Drejtoria e Përgjithshme e Kufirit dhe Migracionit - Enkeleda Toska

### **Ministria e Integrimit:**

Ilirjan Xhezo

Ulpjana Ruka

Jorida Shytaj

### **Ministria e Mireqenies Sociale dhe Rinise:**

Etleva Dyrmishi

Anjeza Ajazi

Kozeta Xhaferaj

Rezarta Omeri

Eriona Arapi

### **Shoqëria Civile**

(IOM)- Teuta Grazhdani, Genc Pjetri

UNHCR- Edlira Baka



International Centre for Migration Policy Development (ICMPD) - Tamara Agolli  
Refugee and Migrant Services in Albania (RMSA) - Mariana Hereni

### **Akademia dhe Ekspertë**

Agency for Research, Technology and Innovation- Geron Kamberi (ARTI)

Universiteti Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë - Fjoralba Caka

Universiteti Tiranës, Fakulteti Ekonomik - Erjona Bezatlliu

Instituti i Kërkimit Un. Marin Barleti - Vjollca Backa

Ora News- Andi Qosja

Edlira Mykaj

Ornela Balla